

VENDIM
Nr. 271, datë 29.3.2017

PËR LËVIZJEN JASHTË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË TË 18
VEPRAVE TË ARTIT NË PIKTURË DHE VIZATIM, PJSË E FONDIT TË GALERISË
KOMBËTARE TË ARTEVE, ME QËLLIM REALIZIMIN E EKSPOZITAVE
“DOCUMENTA 14”, QË DO TË ZHVILLOHEN NË AMBIENTET E MUZEUT
KOMBËTAR TË ARTIT BASHKËKOHOR ATHINË, GREQI, DHE NË MUZEUN E
ARTEVE TË BUKURA, *NEUE GALERIE*, KASSEL, GJERMANI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 19, të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e lëvizjes jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të 15 (pesëmbëdhjetë) veprave të artit në pikturë dhe vizatim, pjesë e fondit të Galerisë Kombëtare të Arteve, me qëllim realizimin e ekspozitës që do të zhvillohet në ambientet e Muzeut Kombëtar të Artit Bashkëkohor, Athinë, Greqi, sipas tabelës I, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 2. Lejimin e lëvizjes jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të 3 (tri) veprave të artit në pikturë dhe vizatim, pjesë e fondit të Galerisë Kombëtare të Arteve, me qëllim realizimin e ekspozitës që do të zhvillohet në ambientet e Muzeut të Arteve të Bukura, *Neue Galerie*, Kassel Gjermani, sipas tabelës II, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 3. Lejimi i lëvizjes të bëhet nga data 31 mars 2017 deri më 6 gusht 2017, për veprat e artit, pjesë e fondit të Galerisë Kombëtare të Artit, që kërkohen të ekspozohen në Muzeun e Artit Bashkëkohor Athinë, Greqi.
 4. Lejimi i lëvizjes të bëhet nga data 2 maj 2017 deri më 8 tetor 2017, për veprat e artit, pjesë e fondit të Galerisë Kombëtare të Artit, që kërkohen të ekspozohen në Muzeun e Arteve të Bukura, *Neue Galerie*, Kassel, Gjermani.
 5. Ekspozimi jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të bëhet në përputhje me udhëzimin nr. 2, datë 18.3.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e lëvizjes së objekteve të trashëgimisë kulturore, të luajtshme, me vlera të veçanta kombëtare dhe unike, për ruajtjen, restaurimin, studimin dhe ekspozimin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”.
 6. Ngarkohet Galeria Kombëtare e Arteve të kryejë shoqërimin dhe kthimin e veprave në vendin e origjinës, pas mbarimit të veprimtarisë, dhe Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore të kryejë regjistrimin e lëvizjes së objekteve.
 7. Ngarkohet ministri i Kulturës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

TABELA I
LISTA E VEPRAVE TË EKSPOZITËS “DOKUMENTA 14” NË ATHINË

Nr.	Nr. i inv.	Emri i autorit	Titulli i veprës	Përmasat	Teknika	Materiali	Viti	Çmimi në ALL
1	50	Kel Kodheli	Emrushë (Arapi)	70 x 56 cm	Vaj	Kompesatë	1944 – 1945	350.000
2	165	Androniqi Antoniu	Autoportret	32 x 43.5 cm	Vaj	Beze	1935	150.000
3	461	Abdurrahim Buza	Refugjatët	50 x 41 cm	Vaj	Kanavacë	1957	500.000
4	485	Abdurrahim Buza	Autoportret	41.5 x 30.5 cm	Vaj	Kompesatë	1934	500.000
5	748	Hasan Nallbani	Me shatë në krah	90 x 70 cm	Vaj	Kanavacë	1966	150.000
6	765	Spiro Kristo	Fëmijët	195 x 200.5 cm	Vaj	Kanavacë	1966	150.000
7	902	Sotir Capo	Prodhuesja e telave elektrike	120 x 93 cm	Vaj	Kanavacë	1969	150.000
8	905	Zef Shoshi	Tornitorja	120 x 85 cm	Vaj	Kanavacë	1969	250.000
9	1166	Llambi Blido	Në pultin e komandimit	118 x 129 cm	Vaj	Kanavacë	1971	150.000
10	1231	Arben Basha	Unë do të shkruaj	102 x 139.5 cm	Vaj	Kanavacë	1971	150.000
11	1828	Spiro Kristo	Brigadierja	110 x 130 cm	Vaj	Kanavacë	1976	100.000
12	1924	Pandi Mele	Ushtarë të revolucionit	124 x 100 cm	Vaj	Kanavacë	1968	150.000
13	2058	Gani Strazimiri	Pazari i vjetër i Tiranës	64 x 99 cm	Vaj	Kompesatë	1936	200.000
14	3538	Foto Stamo	Refugjatët (2)	31 x 47 cm	Vaj	Kompesatë	1941	200.000
15	1307	Edi Hila	Mbjellja e pemëve	150 x 199 cm	Vaj	Kanavacë	1971	350.000

TABELA II
LISTA E VEPRAVE TË EKSPOZITËS “DOKUMENTA 14” NË KASSEL

Nr.	Nr. i inv.	Emri i autorit	Titulli i veprës	Përmasat	Teknika	Materiali	Viti	Çmimi në lekë
1	2759	Androniqi Antoniu	Në kopshtin e fëmijëve	32 x 24 cm	Laps	Letër	1948	50.000
2	2761	Androniqi Antoniu	Në Pazarin e Krujës	28 x 33 cm	Laps	Letër	1938	100.000
3	3585	Hasan Reçi	Cikël për 4 shkurtin (6)	26 x 19 cm	Laps	Letër	-	80.000